

01



Free movement of goods

KAPITULLI 1

Lëvizja e lirë e mallrave

Bashkimi Europian garanton lirinë e lëvizjes dhe shitjes së mallrave në të gjithë territorin e tij sikur ai të ishte një vend i vetëm. Lëvizja e lirë e mallrave është njëra nga katër liritë themelore të BE-së--së bashku me lirinë e lëvizjes së kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve--të cilat përbëjnë bazën e tregut të brendshëm unik.

Liria e lëvizjes së mallrave arrihet përmes:

- a) marrëveshjeve të tregtisë së lirë që heqin tarifatat, kuotat, lejet e importit dhe pengesat e tjera tregtare mes vendeve;
- b) bashkimit doganor i cili heq doganat dhe kontrollet e brendëshme doganore mes Shqipërisë dhe vendeve të BE-së dhe harmonizon standardet dhe praktikatat doganore në lidhje me vendet e treta;
- c) harmonizimit të produkteve — harmonizimit të specifikimeve teknike të produkteve që siguron njohjen reciproke të cilësisë së produkteve që prodhohen në çdo vend të BE-së dhe mundëson që çdo mall që lejohet rregullisht të tregtohet në Shqipëri të lejohet edhe në çdo vend të BE-së dhe anasjelltas.

Për këtë qëllim, Shqipëria duhet të harmonizojë ligjet dhe rregullat e saj të produkteve me ato të BE-së, përfshi standardizimin, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikqyrjen e tregut.

Shqipëria duhet të fuqizojë, gjithashtu, kapacitetet administrative dhe institucionale për mbikqyrjen e tregut dhe zbatimin e rregullave të produkteve për të garantuar që produktet shqiptare përputhen me standardet e cilësisë dhe sigurisë dhe për të mbrojtur konsumatorët nga

produktet e rrezikshme apo të fallsifikuara. Këto masa përfshijnë laboratorët publikë për kontrollin e përputhshmërisë së produkteve, trupat e pavarura për certifikimin e përputhshmërisë së produkteve të reja, sistemin e certifikimit të laboratorëve, një sistem funksional të metrologjisë, anëtarësimin në institucionet e standardizimit të BE-së, etj.

Lëvizja e lirë e mallrave do të sjellë përfitime për bizneset dhe konsumatorët shqiptarë. Në vitin 2023, 72 përqind e gjithë eksporteve të Shqipërisë kishte destinacion vendet e BE-së, ndërkohë që 51 përqind e gjithë importeve erdhën nga një prej vendeve të BE-së, me Italinë dhe Greqinë në krye të listës.

Heqja e doganave dhe kontrolleve kufitare do të ulë kohën dhe koston e transportit të këtyre mallrave nga Shqipëria në vendet e BE-së. Njohja reciproke e cilësisë do të ulë kohën, koston dhe rreziqet për futjen e produkteve shqiptare në BE--nuk do të kërkojnë licensat e importit dhe njohjeje nga secili prej vendeve të BE-së ku eksportohen mallrat.

Përfitimi final do t'u shkojë konsumatorëve shqiptarë të cilët do të përfitojnë një shumëllojshmëri më të madhe mallrash, cilësi më të lartë të tyre dhe kosto më të ulët.

Negociatat për këtë kapitull janë shumë-sektoriale dhe përqendrohen më së shumti në përshtatjen e kuadrit ligjor për produktet.

Grupe me interes për t'u përfshirë:

Shoqatat e biznesit; dhomat e tregtisë dhe industrisë; shoqatat e importuesve dhe eksportuesve; shoqatat e konsumatorëve.

Institucioni udhëheqës i negociatave:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Institucione kyçe të përfshira në negociatë:

- | | |
|--|--|
| • Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | • Ministria e Mjedisit dhe Turizmit |
| • Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | • Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| • Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit | • Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| • Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit | • Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| • Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë | • Ministria e Mbrojtjes |
| • Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut | • Ministria e Brendshme |
| • Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial | |